



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE**

**VENDIM
Nr. 405, datë 4.7.2018**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE MBI DETYRIMIN PËR
VETËDEKLARIM TË ADRESËS NGA SHTETASIT SHQIPTARË QË
JETOJNË JASHTË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE PROCEDURAVE PËRKATËSE QË DO TË NDIQEN
PËR KËTË QËLLIM**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 6, të ligjit nr. 14/2016, “Për identifikimin dhe regjistrimin e adresës së shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”, dhe të ligjit nr. 109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e rregullave për njoftimin e detyrimit për vetëdeklarim të adresës nga shtetasit shqiptarë që jetojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe procedurës së plotësimit e të dorëzimit të formularit të vetëdeklarimit, dokumenteve shoqëruese të tij, si dhe administrimit të tyre nga autoritetet përgjegjëse, Ministria e Brendshme dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.
2. Njoftimi i detyrimit ligjor të vetëdeklarimit të adresës së shtetasve shqiptarë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë nga autoritetet përgjegjëse bëhet sipas këtyre mënyrave:
 - a) Njëpërmjet publikimit në faqet zyrtare elektronike të Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.
 - b) Njëpërmjet programeve, reklamave dhe spoteve për transmetim nga operatorë radiotelevizivë, fletëpalosjeve, takimeve me përfaqësues të shoqatave shqiptare jashtë vendit dhe të organizatave ndërkombëtare që mbrojnë të drejtat e emigrantëve.
3. Shtetasit shqiptarë me banim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë aplikojnë për plotësimin e formularit tip të vetëdeklarimit të publikuar në faqen zyrtare të dy



ministrive përgjegjëse në dy mënyra:

- a) Në mënyrë elektronike;
- b) Në mënyrë manuale.

4. Shtetasit, të cilët aplikojnë në mënyrë elektronike, ndjekin procedurën e përcaktuar në manualin që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Shtetasit, të cilët aplikojnë në mënyrë elektronike, vetëm për t'u njohur dhe për të printuar nga sistemi formularin tip të vetëdeklarimit, ndjekin një të procedurat e mëposhtme:

a) Pasi të kenë shkarkuar, printuar dhe plotësuar formularin, sipas të gjitha rubrikave të përcaktuara në të, e dërgojnë atë me postë pranë misioneve tona diplomatike ose posteve konsullore, nën juridiksionin territorial të së cilës ndodhet banesa e tyre;

b) Pasi të kenë printuar dhe plotësuar formularin sipas të gjitha rubrikave të përcaktuara në të, paraqiten fizikisht pranë misioneve tona diplomatike ose posteve konsullore, nën juridiksionin territorial të së cilës ndodhet banesa e tyre.

6. Shtetasit, të cilët paraqiten pranë zyrave përgjegjëse dhe që nuk kanë aplikuar dhe siguruar formularin, sipas përcaktimit të pikës 5, pajisen me formular nga nëpunësi përgjegjës dhe e plotësojnë atë në prani të tij.

7. Në rastet kur shtetasi plotëson formularin në mënyrë elektronike dhe e konfirmon atë sipas manualit, nuk ka nevojë të paraqitet pranë nëpunësit përgjegjës, pasi ky i fundit ka mundësinë e printimit të tij nga programi i regjistrimit të adresës.

8. Në rastet kur aplikimi i formularit plotësohet në mënyrë manuale, nëpunësi përgjegjës kryen veprimet për identifikimin dhe regjistrimin e adresës në programin e regjistrimit të adresës, sipas manualit të miratuar nga ministri që mbulon shërbimin e gjendjes civile.

9. Nëpunësi përgjegjës, pasi merr formularin e aplikimit në një nga format e parashikuara në këtë vendim dhe pasi ka kryer veprimet sipas pikës 8 të këtij vendimi, përgatit praktikën për konfirmim të adresës nëpërmjet shërbimit postar.

10. Bëjnë përjashtim nga konfirmimi i adresës, nëpërmjet shërbimit postar, rastet kur shtetasi plotëson dhe dorëzon formularin me paraqitjen e tij fizike pranë nëpunësit përgjegjës dhe, bashkë me formularin, paraqet çdo dokument ligjor, i cili provon adresën e tij, të njohur nga autoritetet e vendit ku jeton.



11. Në rastet kur adresa konfirmohet nëpërmjet shërbimit postar, nëpunësi përgjegjës kryen veprimet përfundimtare për regjistrimin e adresës së shtetasve, të cilët janë deklaruar në formular dhe janë verifikuar si pjesëtarë të familjes së deklartuesit, sipas manualit të miratuar për këtë qëllim.

12. Pas përfundimit të procedurës së identifikimit dhe regjistrimit të adresës, nëpunësi përgjegjës do të administrojë dokumentacionin, me anën e të cilit u krye regjistrimi i adresës, sipas rastit:

a) Për aplikimin në mënyrën elektronike dhe në mënyrën manuale para nëpunësit përgjegjës do të ruhet konfirmimi i sjellë nga shërbimi postar;

b) Në rastet kur aplikimi kryhet sipas pikës 10, të këtij vendimi, atëherë nëpunësi përgjegjës do të ruajë, përveç formularit të vetëdeklarimit, edhe kopjen e dokumentacionit me anë të të cilit shtetasi ka provuar adresën e tij.

13. Dokumentacioni, në bazë të të cilit kryhen veprimet për regjistrimin e adresës, siç është përcaktuar në pikën 12, të këtij vendimi, do të ruhet për një afat 5-vjeçar.

14. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi përballohen përkatësisht nga Ministria e Brendshme dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, parashikuar në buxhetin e vitit 2018.

15. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
EDI RAMA